REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 470/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-65462-07-14-2020, me objekt: Loti XII: "*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh – Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale – Bylis + rruga Metohasim - Kafaraj (61,4 km)"*, me fond limit 171.744.991 (njeqind e shtatedhjete e nje milion e shtateqind e dyzete e kater mije e nenteqind e nentedhjete e nje) lekë pa tvsh, faza e parë parakualifikuese zhvilluar me date 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k
Rr. "Q.Stafa", P. 66, Sh. 3, Ap.24, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Rruga "Sami Frashëri", nr.33, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-65462-07-14-2020, me objekt: Loti XII: "*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh – Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale – Bylis + rruga Metohasim - Kafaraj (61,4 km)"*, me fond limit 171.744.991 (njeqind e shtatedhjete e nje milion e shtateqind e dyzete e kater mije e nenteqind e nentedhjete e nje) lekë pa tvsh.

II.2. Faza e parë parakualifikuese është zhvilluar me date 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Operatorët ekonomikë që kanë shprehur interes janë si vijon:

1. "Shendelli" sh.p.k
2. "Shkelqimi" sh.p.k
3. "K.M.K" sh.p.k
4. "6D-Plan" sh.p.k
5. "Be-Is" sh.p.k
6. "Boshnjaku B" sh.p.k
7. "Alko Impex General Construcsion" sh.p.k

II.3. Në datën 31.08.2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar në SPE fazën parakualifikuese dhe operatorët ekonomikë që kanë shprehur interes në procedurën e prokurimit janë nëpërmjet SPE-së si vijon.

1. "Shendelli" sh.p.k kualifikuar
2. "Shkelqimi" sh.p.k skualifikuar
3. "K.M.K" sh.p.k skualifikuar
4. "6D-Plan" sh.p.k skualifikuar
5. "Be-Is" sh.p.k skualifikuar
6. "Boshnjaku B" sh.p.k skualifikuar
7. "Alko Impex General Construcsion" sh.p.k kualifikuar

BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k "Leon Konstruksion" sh.p.k është njoftuar elektronikisht nga KVO për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë:

"Skualifikohet bashkimi i operatorëve ekonomikë "BE-IS & GRIALD" sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kritereve te kerkuara ne DT dhe bazes ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP. Konkretisht mungon mjeti Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails) pasi OE BE-IS paraqet vetëm një faturë tatimore me datë 10.07.2020, të pa shoqëruar me dokumente që vërtetojnë origjinën dhe ekzistencën e mjetit, kjo në kundërshtim me DT ku kërkohet që për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese.

Mungon mjeti "Autobot Uji" për të cilin anëtari i BOE GRIALD për të plotësuar këtë kriter paraqet kontratë qeraje me subjektin ÇELMANI. Automjeti me targë AA095VO i paraqitur si Autobot Uji eshte kamion ATV me kod karrocerie C3 (çisterne per transport lëndësh të rrezikshme te ndezshme dhe nenprodukteve te naftes). Certifikata eshte per transport mallrash te rrezikshme."

II.4. Në datën 03.09.2020, BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

" [...]

Sipas KVO-se per mjetin batipal nuk eshte paraqitur dokumentacion i plote shoqerues sic eshte kerkuar ne DT, duke pretenduar se krahas fatures tatimore duhet te paraqitej edhe kontrata e blerjes dhe zhdoganimi.

Kjo nuk qendron sepse:

Ne DT eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte.

18	*Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; - çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot*

perkatese, me ngjyra ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit te komntrates / kontratave.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre"*

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik e me konkretisht neni 46 i LPP si dhe neni 26 i VKM 914/2014, vendosja e kritereve te vecanta per kualifikim (ku ben pjese edhe kerkesa per mjetin batipal) ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, tc cilet, neperrnjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshrnerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Me ane te kriterit te mesiperm si dhe dokumentacionti te kerkuar, qellimi i autoritetit kontraktor eshte vertetimi se operatoret ekonomike pjesemarres dhe/ose anetaret e bashkimit te operatoreve ekonomike, ne perputhje me nenin 74 pika 3 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar, disponojne makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, per te zbatuar me sukses kontraten ne rastin e shpalljes fitues.

Pikerisht per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri, kemi paraqitur:

Faturen tatimore te shitjes nr 19 date 10.07.2020 me shites Adriatik Islamaj Durres dhe bleres BE- IS shpk ku pershkruhen edhe te dhenat e sendit si dhe fotot e mjetit.

Deklarata "Mbi disponueshmerine e mjeteve" ku ne rreshtin nr 19 eshte pershkruar disponueshmeria e Batipalit.

Deklarata per kapacitet teknike per mosangazhimin e mjeteve dhe vendodhjen e tyre.

Dokumentacioni i paraqitur eshte ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor, duke e plotesuar kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Kjo sepse, ne rastin konkret ju kemi paraqitur dokumentacion te plote qe te krijoni bindjen se disponojme mjetin batipal,ne perputhje me kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Pretendimi se ky kriter konsiderohet i paplotesuar sepse nuk kemi paraqitur kontrate shitblerje apo fature zhhdoganimi eshte sa i pambeshtetur ne legjislacionin e aplikueshem por edhe absurd e i pallogjikshem. -

Rregullat e prokurimit parashikojne qe vleresimi i ofertave behet nga anetaret e KVOse te cilet jane detyrimisht me arsim te larte dhe pergjithesisht specialiste te fushes.

Kjo nenkupton se keta anetare te KVO nuk kane si synim gjetjen e mangesive te metave me qellim skualifikimin e pjesemarresve por nepermjet dokumentacionit te paraqitur te vleresojne nese

operatori ofertues e disponon mjetin a pajisjen e kerkuar ne DT qe do ti duhet gjate kohes se zbatimit te kontrates.

Ne arsyetimin e skualifikimit nuk jepet ndonje argument se perse dokumentat e paraqitura si fatura tatimore e shitjes, fotot (madje ne foto eshte edhe nje punonjes i BE IS shpk me jelekun me logon e BE- IS shpk), deklaratat per vendndodhjen e dipsoninim e ketij mjeti, nuk i kane mjaftuar KVO te krijoje bindjen se kete mjet Be-Is sh.p.k e disponon.

Cfare garancie te shtuar do te fitonte AK nqs do ti ishte paraqitur edhe nje kontrate shitje e formalizuar me shkrim dhe nenshkruar nga shitesi dhe bleresi. Duke qene se kjo kontrate nuk kerkohet te jete noteriale e cfare do ti pengonte shitesin e bleresin qe kane pranuar faturen tatimore te shitjes

Nuk besojme qe KVO ka arritur ne konkluzionin e mosdisponimit se ketij mjeti nga mungesa e dokumentit te zhdoganimit sepse ne keta rast do te kalonte perfytyrimin normal te arsyetimit te njerezve me arsim te larte sic duhet te kene qene anetaret e KVOse.

Mjeti batipal i paraqitur sic duket edhe nga fotot e paraqitura eshte mjet i perdorur por ne gjendje shume te mire pune. E duke qene i perdorur ska patur anje pengese ligjore te kete nderruar pronesine disa here sipas interesit se shitesve apo bleresve. Keshtu qe, nuk ka asnje detyrim ligjor qe bleresi i fundit ti kerkoje shitesit edhe faturen e zhdoganimit qe e ka patur bleresi i pare qe e ka futur ne vendin tone. Nuk eshte mjet qe rregjistrohet ne rregjistrat publik apo kadaster qe te kerkohet origjina e pronesise, dokumentin e zhdoganimit e ka patur bleresi i pare i cili nuk eshte pjesemarres si ofertues ne kete procedure, madje as edhe shitesi nga i cili e ka blere BE-IS shpk nuk eshte pjesemarres ne prokurim. Qenia e tij si shites te nje sendi qe e paraqet BE IS shpk si pjesemarres ne konkurim, nuk e detyron kete te fundit ti nenshtrohet rregullave dhe dispozitave ligjore te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili strictu sensu shtrin efektet vetem mbi palet ne nje procedure prokurimi (autoritet kontraktor- operator ekonomik) dhe ne asnje rast te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga lex specialis nuk shtrihen njeherazi edhe mbi pale te treta, te cilet kane lidhur marredhenie kontraktuale me operatoret ekonomike pjesemarres, pale te procedures se prokurimit.

Ne rastin konkret, Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh metalik (guardrails), ne kuptim te K. Civil eshte ne send i luajtshem e qe sic e pranon edhe KVO-ja nuk ka detytrim ligjor sipas K. Rrugor te rregjistrohet ne rregjistrat publike.

Keshtu qe, fatura tatimore e shitjes eshte dokument ligjor i mjaftueshem qe konfirmon kryerjen e transaksionit dhe pronesine e BE-IS shpk mbi kete send.

Qysh nga koha e sistemit te se drejtes romake e ne vijimesi, legjislacioni i shitjes nuk ka parashikuar ndonjehere qe fitimi i pronesise se sendeve te luajtshem duhet detyrimisht te formalizohet me kontrate te shkruar shitje.

Ne shitjen e sendeve te luajtshme nuk kerkohet nje formalitet i tille, por e drejta e pronesise i kalon fituesit kur atij edhe i dorezohet sendi, sic edhe ka ndodhur ne rastin konkret.

Duke pasur parasysh se kontrata e shitjes eshte nje veprim juridik i dyanshern, ajo i nenshtrohet rregullave te pergjithshme te formes se veprimit juridik. Sipas nenit 80 te Kodit Civil, veprimi juridik mund te kryhet me shkrim, me goje dhe me cdo lloj shfaqje te padyshimte te vullnetit, ku me kete te fundit nenkuptohen veprimet konkludente.

Leshimi i fatures tatimore te shitjes ne rastin konkret eshte veprimi konkludent qe palet deshmojne se veprimi i kalimit te pronesise se sendit ka ndodhur dhe pronar i sendit te shitur me faturen tatimore 19 date 10.07.2020 eshte BE-IS shpk.

Neni 79 i K.Civil ka parashikuar se:

Perkufizimi i veprimit juridik

Veprimi juridik eshte shfaqja e ligjshme e vullnetit te personit fizik ose juridik, qe synon te krijoje, te ndryshoje ose te shuaje te drejta ose detyrime civile.

Veprimi juridik mund te jete i njeanshem ose i dyanshem.

Kurse neni 80 parashikon shprehimisht se: –

Format e veprimit juridik

Veprimi juridik mund te kryhet me shkrim, me goje dhe me cdo lloj shfaqje tjeter te padyshimte te vullnetit.

Ne nenin 705 te Kodit Civil eshte parashikuar se:

Kontrata e shitjes ka per objekt kalimin e pronesise se nje sendi ose kalimin e nje te drejte kundrejt pagimit te nje cmimi.

Ne nenin 710 te Kodit Civil eshte parashikuar se:

Detyrimet kryesore te shitesit jane:

1. t'i dorezoje sendin bleresit;

2. kur fitimi i pronesise mbi sendin, ose i te drejtave reale mbi te, nuk eshte pasoje e menjehershme e kontrates, duhet te dorezoje te gjitha dokumentet perkatese per fitimin e pronesise se tyre, sipas kushteve te parashikuara nga kontrata apo nga ligji;

3. te garantoje bleresin nga zhveshja, nga veset dhe nga mosperputhja e cilesive te sendit me kontraten.

Neni 49 i ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", parashikon se ;

Fatura tatimore

Cdo shitblerje mallrash apo te drejtash, si dhe cdo kryerje punimi apo sherbimi, qe eshte pjese e veprimtarise tregtare, eshte objekt faturimi.

Neni 50

Fatura tatimore me TVSH

Tatimpaguesi, qe i nenshtrohet tatimit mbi vleren e shtuar (TVSH), sa here qe ofron mallra apo sherbime per nje person tjeter, duhet te leshoje fature tatimore me TVSH, ne perputhje me ligjin nr. 92/2014, "Per tatimin mbi vleren e shtuar", te ndryshuar".

Neni 51

Leshimi i fatures tatimore

1. Shitesi leshon fature tatimore dhe bleresi duhet ta kerkoje ate ne kohen e realizimit te shitjes apo te kryerjes se punimit ose sherbimit. Fatura tatimore pergatitet nga shitesi ne jo me pak se dy kopje, nga te cilat njeren e merr dhe e ruan bleresi, kurse tjetren e mban dhe e ruan shitesi. Faturat pergatiten me numer rendor progresiv

Nga sa me lart konkludohet lehtesisht se:

Fatura tatimore e paraqitur nr 19 date 10.07.2020 verteton plotesisht se;

Leshimi i kesaj fature eshte shprehje e vullnetit dypalesh te shitesit e bleresit per kryerjen e transaksionit te shitjes se sendit batipal.

Nenshkrimi e vulosja nga perfaqesuesit e te dy paleve shites e bleres konfirmon kalimin e pronesise nga shitesi tek bleresi BE-IS shpk.

Referuar e ne zbatim te percaktimeve te nenit 49 te ligjit 9920/2008, fatura tatimore e paraqitur pervec te tjerave, permban emrin dhe adresen e paleve, daten e realizimit te shitjes ose sherbimit, emertimin e sakte te tyre, cmimin e plote te shitjes, daten dhe vendin e leshimit, si dhe emrin NIPT e adresen e paleve. Nga permbajtja e ketyre elementeve ne faturen tatimore, te paraqitura ne SPE, ne provojme para AK, faktin krijues te se drejtes sone mbi pronesine e sendit Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh metalik (guardrails).

Lidhur me sa me siper, ne theksojme se detyrimi yne lidhet vetem ne provimin e fakteve per te cilat kemi barren e proves (te disponimit te mjetit batipal) ndersa persa i perket dyshimit te KVOse se nuk e dipsonojme kete mjet ky perben nje fakt shues, per te cilin ne si ofertues nuk kemi detyrim qe te paraqesim ndonje prove. Detyrimi per te provuar kete fakt shues i perket KVO-se, e cila normalisht e gjate arsyetimit te skualifikimit do duhej te paraqiste argumenta e prova perse nuk eshte bindur se nuk e diponojme kete mjet. Persa kohe qe nje fakt i tille KVO nuk arrin ta provoje, atehere nuk qendron arsyeja e skualifikimit .

Nga ana tjeter, KVO nqs nuk ka qene e bindur apo kishte dyshime per vertetesine e deklarimeve per disponimin e ketij mjeti, mund te shfrytezonte te drejten qe i jep ligji per te kerkuar shpjegime apo dokumentacion tjeter shtese por edhe te shfrytezonte parashikimin e DT per verifikimin ne vendin ku BE IS shpk ka deklaruar se ndodhet ky mjet. Po keshtu ka patur edhe autorizimin nga BE-IS qe ne cdo kohe mund te bente kete verifikim me ose pa paralajmerin.

Gjithashtu , neni 62 i LPP i jep mundesine AK qe edhe gjate fazes se zbatimit te kontrates ne cdo kohe te kontrollonte deklarimin mbi disponueshmerine e ketij mjeti. Per sa me siper, kjo arsye skualifikimi nuk qendron.

2. KVO na ka skualifikuar edhe sepse, automjeti me targe AA095VO i deklaruar nga Griald shpk nuk eshte autobot uji por automjet per transport lendesh te rrezikshme, te ndezeshme dhe neprodukteve te naftes.

Ne DT eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte

7 Autobot uji ne pronesi ose me qira Cope 1

Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit, certifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; certifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates/kontratave.

Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate me shkrim per disponueshrnerine e mjeteve gjate gjithe periudhes se realizimit te kontrates/kontratave.

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre"*

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri nga Griald shpk eshte paraqitur ;
Kontrata noteriale e qerase nr 8323 rep. nr 3192 kol date 05.08.2020 per mjetin me targe AA 095 VO, me qeradhenes CELAMI shpk si dhe dokumentacion i plote shoqerues ku perfshihen: leje qarkullimit. certifikata e pronesise, siguracioni, kontrolli teknik, taksat e paguara, certifikate transporti mallra te rrezikshme, foto te mjetit.
Nga KVO nuk pretendohet per mungese dokumentacioni shoqerues qe duhet te kishte ky automjet por ky automjet nuk konsiderohet se ploteson kriterin per autobot uji mqs transporton mallra te rrezikshme
Ne nenin 54 te ligjit nr.8308 date 18.03.1998 "Per transporter rrugore", te ndryshuar, parashikohet se: a) Mallrat e rrezikshme jane lende a sende qe per vetite e tyre (helmim, shperthim, vetendezje, avullim, infeksionim dhe radioaktivitet) paraqesin gjate transportimit rrezik per sigurimin e njerezve dhe te mjedisit. b) Klasifikimi dhe emertimi i mallrave te rrezikshme percaktohet ne aktet e Keshillit te Ministrave. c) Eshte i ndaluar transportimi i mallrave te rrezikshme pa leje te leshuar nga ministri ose organet e autorizuara prej tij. Perjashtohen nga lejet transporti i mallrave te rrezikshme me mjete te Forcave te Armatosura gjate permbushjes se detyrave te tyre.
Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KVO ka konstatuar se automjeti per transport te vecante AA 095VO shfaq nivelin me te larte te sigurise, duke u certifikuar njeherazi per transport mallrash te rrezishme brenda vendit. Ne interpretim te dispozites se sipercituar, KVO duhet te gjykonte se certifikimi i mesiperm i ketij mjeti, si i afte per transport mallrash te rrezikshme, i propozuar si i disponueshern nga anetari i bashkimit te operatoreve ekonomike, permbush kriterin ne drejtim te certifikimit per transport te mallrash brenda vendit, akome me tej edhe per mallra te rrezikshme ne kuptim te Ligjit nr.8308/1998 si edhe njeherazi per kryerjen e synimit te parashikuar nga autoriteti kontraktor (transport uji).
Referuar edhe praktikes se vendimarrjeve te KPP, skualifikimi per autobotet e naftes te deklaruar per tu perdorur si autobote uji eshte konsideruar i paligjshem.
Sa me siper kjo arsye skualifikimi nuk qendron."

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 6431/1 prot., datë 11.09.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon:
"[…]
Lidhur me pretendimin e BOE BE-IS & GRIALD sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] mungon mjeti Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh metalik (guardrails) pasi OE BE-IS paraqet vetem nje fature tatimore me date 10. 07. 2020, te pa shoqeruar me dokumente qe vertetojne origjinen dhe ekzistencen e mjetit, kjo ne kundershtim me DT ku kerkohet qe per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese", Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se ne shtojcen 10, "Kriteret e vcanta te kualifikimit", ne dokumentat standarde te tenderit te procedures se prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kerkuar si vijon: Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme

teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte.

Nr	***Lloji i Makinerive***	***Pronësia***	***Sasia***
.	...		
18	*Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
.	...		

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave. [...]*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se per te deshmuar disponueshmerine e Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh, metalik (guardrails) anetari i BOE ka paraqitur vetem faturen tatimore me date 10.07.2020, te pa shoqeruar me dokumente qe vertetojne origjinen dhe ekzistencen e mjetit, kjo ne kundershtim me DT. Ky fakt pranohet dhe vete nga operatori ekonomik ankimues ne ankesen e paraqitur prej tij. K.Sh.A konstaton se i njejti mjet eshte paraqitur edhe ne nje procedure tjeter te zhvilluar nga AK, Loti 7 ne DRQ Tirane. Mjeti i paraqitur me kete fature tatimore eshte nje mjet i prodhuar dhe importuar nga jashte vendit dhe gjithashtu eshte mjet qe nuk shenohet ne regjistra publike, i cili kur eshte ne pronesi, duhet te paraqitet kontrata e blerjes/cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates/kontratave. Pra, ne dst me termin "duhet te" kerkohet detyrimisht dhe qartesisht bashkesia e dokumenteve qe vertetojne origjinen e mjetit me te cilen eshte bere pronar shitesi i tij. Eshte detyrim i operatorit pjesmarres ne tender, sigurimi ne teresi dhe jo pjeserisht, i dokumentacionit justifikues ne perputhje me dst. Vetem paraqitja e fatures tatimore (e cila edhe mund te anullohet pas prerjes se saj) dhe e fotos me punonjesin me jelekun me logo (e cila mund te kete vlera artistike) nuk krijojne bindjen se operatori e disponon vertet kete mjet.

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

Lidhur me pretendimin e BOE BE-IS & GRIALD sh.p.k, mbi skualifikimin e tij me arsyen: "[...] Mungon mjeti "Autobot Uji" per te cilin anetari i BOE GRIALD per te plotesuar kete kriter paraqet kontrate qeraje me subjektin Çelmani. Automjeti me targe AA095VO i paraqitur si Autobot Uji eshte kamion ATV me kod karrocerie Ç3 (cisterne per transport lendesh

te rrezikshme te ndezshme dhe nenprodukteve te naftes). Certifikata eshte per transport mallrash te rrezikshme [...] ", Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se, ne shtojcen 10, "Kriteret e vcanta te kualifikimit", ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kerkuar si vijon: "Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte.

Nr	***Lloji i Makinerive***	***Pronësia***	***Sasia***
7	*Autobot uji*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, K.Sh.A. konstaton se per te deshmuar disponueshmerine e Autobotit te ujit, anetari i BOE GRIALD shpk ka paraqitur kontraten noteriale te qerase nr.Rep 8413, nr.Kol. 3240, date 06.08.2020 me qeradhenes shoqerine Celmani. K.Sh.A konstaton se i njejti mjet eshte paraqitur edhe ne nje procedure tjeter te zhvilluar nga AK, Loti 7 ne DRQ Tirane. K.Sh.A arsyeton se nepermjet kesaj kontrate qeradhenesi deklaron para noterit publik se eshte pronar i makinerive/mjeteve "Autobot uji" me targa AA095VO me vit prodhimi 2006. Sipas dokumentacionit, mbi pronesine e mjetit, bashkengjitur kontrates se qerase, midis tyre certifikata me nr 152 date 25.02.2019 e leshuar nga DRSHTRR Durres, dhe foto e mjetit rezulton qe ky mjet (i permasava te medha) eshte per transport nderkombetar mallrash te rrezikshem. Eshte e pallogjikshme qe nje mjet i ketyre permasave dhe ketij viti prodhimi do te lejohej nga qeradhenesi te perdorej per transport uji. Me deklarimin e qeradhenesit, para noterit publik, dhe me paraqitjen e mjetit me targe AA095VO nga operatori GRIALD shpk kemi te bejme me deklarim te rreme per qellime kualifikimi. Pranimi i ketij mjeti si autobot uji do te rezultonte diskriminues per konkurrentet e tjere pjesemarres.
Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron."

II.5. Në datën 18.09.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 01.10.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1134/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 7058/1 prot., datë 29.09.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.kse: "*bashkimi i operatorëve ekonomikë "BE-IS & GRIALD*" *nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kritereve te kerkuara ne DT dhe bazes ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP. Konkretisht mungon mjeti Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails) pasi OE BE-IS ka paraqitur vetëm një faturë tatimore me datë 10.07.2020, të pa shoqëruar me dokumente që vërtetojnë origjinën dhe ekzistencën e mjetit, kjo në kundërshtim me DT ku kërkohet që për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.10 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik si me poshte.

Nr	***Lloji i Makinerive***	***Pronësia***	***Sasia***
1	*Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 tonë*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 3*
2	*Grejder*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
3	*Rrul vibrues*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
4	*Prerëse asfalti*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
5	*Frezë asfalti*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
6	*Betoniere*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 2*
7	*Autobot uji*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
8	*Autobitumatriçe*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
9	*Asfaltoshtruese*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
10	*Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 6*
11	*Kamionçinë deri në 3.5tonë*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 2*
12	*Minieskavator*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
13	*Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
14	*Fadromë*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
15	*Ekskavator me zinxhirë*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
16	*Ekskavator me goma*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
17	*Makineri për vijëzim rrugor*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
18	*Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)*	*në pronësi ose me qira*	*Copë 1*
19	*Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore*	*pronësi /qira/ kontrate furnizim*	*Copë 1*

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese, me ngjyra, ku te jete e dukshme edhe targa e mjetit; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*
- *Për fabriken e asfaltobetonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.*
- *Operatori ekonomik per fabriken e asfaltobetonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit te komntrates / kontratave.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre"*

  Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

*****Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara me vulë apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës se Shqipërisë ne Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare te huaja". (Konventa e Hagës 5 TETOR 1961)***

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi lidhur ndërjmet shoqërisë "Be-Is" sh.p.k dhe shoqërisë "Griald" sh.p.k., nga ku shoqëria "Be-Is"

sh.p.k merr përsipër realizimin e objektit të mësipërm të prokurimit në masën 60 % dhe shoqëria "Griald" sh.p.k merr përsipër realizimin e kontratës në masën 40 %.
Gjithashtu, është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Be-Is" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, rezulton se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, është paraqitur si më poshtë vijon:

I. Shoqëria "Be-Is" sh.p.k. ka paraqitur:

- Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku, ndër të tjera, është deklaruar në pronësi mjeti Batipal me faturë tatimore shitje nr.19, datë 10.07.2020, si më poshtë vijon:

DEKLARATE MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: **"BE - IS" SHPK deklaron:**

Unë i nënshkruari, **Kastriot IBRAHIMAJ,** me cilësinë e **Administratorit** të operatorit ekonomik **"BE - IS" SHPK,** deklaroj se zotëroj mjetet, pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: **"Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh – Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale – Bylis + rruga Metohasim - Kafaraj (61,4 km)".**

	NË PRONËSI				
Nr.	**Lloji i Mjetit**	**Targa**	**Nr. Lejes së qarkullimit**	**Nr. Shasisë**	**Të tjera**
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 8 ton	AA941OZ	TRDA5551016	WDB9523141K828193	Çertifikatë Pronësie e Mjetit MERCEDEZ BENZ
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 8 ton	AA905VF	TRDA4753618	WDB9523141K701338	Çertifikatë Pronësie e Mjetit MERCEDEZ BENZ
3.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 8 ton	AA417JS	TRDB5317514	WJME3TRS00C092820	Çertifikatë Pronësie e Mjetit IVECO MAGIRUES
4.	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	AA108HK	TRF1224213	WDB6690411N002009	Çertifikatë Pronësie e Mjetit MERCEDES BENZ
5.	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	AA079XJ	TRDA1154819	WDB9062331N467017	Çertifikatë Pronësie e Mjetit MERCEDEZ BENZ
6.	Autobitumatrice	AA782FA	TRDB0695812	WDB6760121K113921	Çertifikatë Pronësie e Mjetit MERCEDES BENZ
7.	Asfaltoshtruese				R21790
8.	Fadromë	ADMT 41	TRDA5199016	97SF11084	Çertifikatë Pronësie e Mjetit KOMATSU
9.	Rrula				Faturë tatimore shitje nr.98 , datë 25.03.2010 R33601 ,R37965 ,R88617, R21790 Faturë tatimore shitje Nr.1444 datë 20.05 2016
10.	Eskavatorë me zinxhir				Faturë tatimore shitje nr.21 datë 30.11.2009 Faturë tatimore shitje nr.108, datë 23.12.2016 Faturë tatimore shitje nr.54 datë 06.06.2017 R 67834 , R 3277
11.	Minieskavator				Faturë tatimore shitje nr.45 datë 29.03.2010 Faturë tatimore shitje nr.105 datë 12.12.2016 Faturë tatimore shitje nr.80 datë 13.06.2011
12.	Prerese Asfalti				Faturë tatimore shitje nr.118 datë 04.05.2009 R63796

13.	Freza Asfalti				R44345 Faturë tatimore shitje nr.10 datë 16.05.2011 Faturë tatimore shitje nr.417 datë 21.02.2014
14.	Betoniere				Faturë tatimore shitje nr.54 , datë 06.02.2008 Faturë tatimore shitje nr.533, datë 16.05.2007 Faturë tatimore shitje nr.237 datë 03.10.2007 Faturë tatimore shitje nr.208,datë 15.08.2009 Faturë tatimore shitje nr.237,datë 03.10.2007 Faturë tatimore shitje nr.31 , datë 24.02.2011 Faturë tatimore shitje nr.1 , datë 06.05.2011 R 22 500 Faturë tatimore shitje nr.008,datë 09.05.2011
15.	Minifadroma				R21786 R91834
16.	Eskavator me goma	AGMT42	TRF0030218	93F20054	Çertifikatë Pronësie e Mjetit KOMATSU
17.	Mjet Batipal				Faturë tatimore shitje nr. 19,datë 10.07.2020
18.	Motomjete prerese 4 cope				Faturë tatimore shitje nr. 304,datë 04.08.2020 Faturë tatimore shitje nr. 39420 ,datë 18.04.2016

ME QERA

Nr.	Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kontratës së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1.	Fabrike Asfaltobetoni me QKL				Nr. 8327 Rep. Nr. 3196 Kol	05.08.2020-05.08.2025

Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

- Referuar Deklaratës së mësipërme është paraqitur dokumentacion për mjetin Batipal, si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje n.19, datë 10.07.2020, me shitës A.I dhe blerës shoqërinë "Be-Is" sh.p.k
- Foto të mjetit.

II. Shoqëria "Griald" sh.p.k" sh.p.k. ka paraqitur:

- Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku janë deklaruar këto mjete:

DEKLARATE MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: **"GRIALD" SHPK deklaron:**

Unë i nënshkruari, **Gezim Halili,** me cilësinë e **Administratorit** të operatorit ekonomik **"GRIALD" SHPK,** deklaroj se zotëroj mjetet, pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: **"Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh – Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale – Bylis + rruga Metohasim - Kafaraj (61,4 km)".**

	ME QERA					
Nr.	Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kontratës së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 8 ton	AA966RC	TRDA1393117	YV2J4CFG43B329197	Nr. 8324 Rep Nr. 3193 kol	05.08.2020-Perfundimin e plote te kontrates.
2.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 8 ton	AA972BB	TRF2273517	YV2J4CEG14B352584	Nr. 8324 Rep Nr. 3193 kol	05.08.2020-Perfundimin e plote te kontrates.

3.	Grejder				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
4.	Eskavator me zinxhire				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
5.	Rrul vibrues				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
6.	Minieskavator				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
7.	Sharre Asfalti				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
8.	Betoniere				Nr. 8325 Rep Nr. 3194 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
9.	Grejder				Nr. 8342 Rep Nr. 3203 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
10.	Motomjete prerese				Nr. 8343 Rep Nr. 3204 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
11.	Makineri Vijezimi				Nr. 8326 Rep Nr. 3195 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.
12.	Autobot Uji	AA095VO	DRD1862318	WDB9302031L28925	Nr. 8323Rep Nr. 3192 kol	05.08.2020- Perfundimin e plote te kontrates.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"*Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se:

"*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet:

"*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*

III.1.6. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se

"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

III.1.7. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenënë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".*

III.1.8. Operatori ekonomik ankimues pretendon se: *"Me ane te kriterit te mesiperm si dhe dokumentacionti te kerkuar, qellimi i autoritetit kontraktor eshte vertetimi se operatoret ekonomike pjesemarres dhe/ose anetaret e bashkimit te operatoreve ekonomike, ne perputhje me nenin 74 pika 3 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar, disponojne makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, per te zbatuar me sukses kontraten ne rastin e shpalljes fitues. Pikerisht per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri, kemi paraqitur: Faturen tatimore te shitjes nr 19 date 10.07.2020 me shites Adriatik Islamaj Durres dhe bleres BE- IS shpk ku pershkruhen edhe te dhenat e sendit si dhe fotot e mjetit. Deklarata "Mbi disponueshmerine e mjeteve" ku ne rreshtin nr 19 eshte pershkruar disponueshmeria e Batipalit. Deklarata per kapacitet teknike per mosangazhimin e mjeteve dhe vendodhjen e tyre. Dokumentacioni i paraqitur eshte ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor, duke e plotesuar kriterin e percaktuar ne dokumentat e tenderit. Kjo sepse, ne rastin konkret ju kemi paraqitur dokumentacion te plote qe te krijoni bindjen se disponojme mjetin batipal, ne perputhje me kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Pretendimi se ky kriter konsiderohet i paplotesuar sepse nuk kemi paraqitur kontrate shitblerje apo fature zhhdoganimi eshte sa i pambeshtetur ne legjislacionin e aplikueshem por edhe absurd e i pallogjikshem.*
Kjo nenkupton se keta anetare te KVO nuk kane si synim gjetjen e mangesive te metave me qellim skualifikimin e pjesemarresve por nepermjet dokumentacionit te paraqitur te vleresojne nese operatori ofertues e disponon mjetin a pajisjen e kerkuar ne DT qe do ti duhet gjate kohes se zbatimit te kontrates. Ne arsyetimin e skualifikimit nuk jepet ndonje argument se perse dokumentat e paraqitura si fatura tatimore e shitjes, fotot (madje ne foto eshte edhe nje punonjes i BE IS shpk me jelekun me logon e BE- IS shpk), deklaratat per vendndodhjen e dipsoninim e ketij mjeti, nuk i kane mjaftuar KVO te krijoje bindjen se kete mjet Be-Is sh.p.k e disponon. Cfare garancie te shtuar do te fitonte AK nqs do ti ishte paraqitur edhe nje kontrate shitje e formalizuar me shkrim dhe nenshkruar nga shitesi dhe bleresi. Duke qene se kjo kontrate nuk kerkohet te jete noteriale e cfare do ti pengonte shitesin e bleresin qe kane pranuar faturen tatimore te shitjes. Nuk besojme qe KVO ka arritur ne konkluzionin e

mosdisponimit se ketij mjeti nga mungesa e dokumentit te zhdoganimit sepse ne keta rast do te kalonte perfytyrimin normal te arsyetimit te njerezve me arsim te larte sic duhet te kene qene anetaret e KVO-se. Mjeti batipal i paraqitur sic duket edhe nga fotot e paraqitura eshte mjet i perdorur por ne gjendje shume te mire pune. E duke qene i perdorur ska patur anje pengese ligjore te kete nderruar pronesine disa here sipas interesit se shitesve apo bleresve. Keshtu qe, nuk ka asnje detyrim ligjor qe bleresi i fundit ti kerkoje shitesit edhe faturen e zhdoganimit qe e ka patur bleresi i pare qe e ka futur ne vendin tone. Nuk eshte mjet qe rregjistrohet ne rregjistrat publik apo kadaster qe te kerkohet origjina e pronesise, dokumentin e zhdoganimit e ka patur bleresi i pare i cili nuk eshte pjesemarres si ofertues ne kete procedure, madje as edhe shitesi nga i cili e ka blere BE-IS shpk nuk eshte pjesemarres ne prokurim. Qenia e tij si shites te nje sendi qe e paraqet BE IS shpk si pjesemarres ne konkurim, nuk e detyron kete te fundit ti nenshtrohet rregullave dhe dispozitave ligjore te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili strictu sensu shtrin efektet vetem mbi palet ne nje procedure prokurimi (autoritet kontraktor-operator ekonomik) dhe ne asnje rast te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga lex specialis nuk shtrihen njeherazi edhe mbi pale te treta, te cilet kane lidhur marredhenie kontraktuale me operatoret ekonomike pjesemarres, pale te procedures se prokurimit. Ne rastin konkret, Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh metalik (guardrails), ne kuptim te K. Civil eshte ne send i luajtshem e qe sic e pranon edhe KVO-ja nuk ka detytrim ligjor sipas K. Rrugor te rregjistrohet ne rregjistrat publike. Keshtu qe, fatura tatimore e shitjes eshte dokument ligjor i mjaftueshem qe konfirmon kryerjen e transaksionit dhe pronesine e BE-IS shpk mbi kete send.

Qysh nga koha e sistemit te se drejtes romake e ne vijimesi, legjislacioni i shitjes nuk ka parashikuar ndonjehere qe fitimi i pronesise se sendeve te luajtshem duhet detyrimisht te formalizohet me kontrate te shkruar shitje. Ne shitjen e sendeve te luajtshme nuk kerkohet nje formalitet i tille, por e drejta e pronesise i kalon fituesit kur atij edhe i dorezohet sendi, sic edhe ka ndodhur ne rastin konkret. Duke pasur parasysh se kontrata e shitjes eshte nje veprim juridik i dyanshern, ajo i nenshtrohet rregullave te pergjithshme te formes se veprimit juridik. Sipas nenit 80 te Kodit Civil, veprimi juridik mund te kryhet me shkrim, me goje dhe me cdo lloj shfaqje te padyshimte te vullnetit, ku me kete te fundit nenkuptohen veprimet konkludente.

Leshimi i fatures tatimore te shitjes ne rastin konkret eshte veprimi konkludent qe palet deshmojne se veprimi i kalimit te pronesise se sendit ka ndodhur dhe pronar i sendit te shitur me faturen tatimore 19 date 10.07.2020 eshte BE-IS shpk. Neni 79 i K.Civil ka parashikuar se:

Perkufizimi i veprimit juridik

Veprimi juridik eshte shfaqja e ligjshme e vullnetit te personit fizik ose juridik, qe synon te krijoje, te ndryshoje ose te shuaje te drejta ose detyrime civile. Veprimi juridik mund te jete i njeanshem ose i dyanshem.

Kurse neni 80 parashikon shprehimisht se: –

Format e veprimit juridik

Veprimi juridik mund te kryhet me shkrim, me goje dhe me cdo lloj shfaqje tjeter te padyshimte te vullnetit.

Ne nenin 705 te Kodit Civil eshte parashikuar se:

Kontrata e shitjes ka per objekt kalimin e pronesise se nje sendi ose kalimin e nje te drejte kundrejt pagimit te nje cmimi.

Ne nenin 710 te Kodit Civil eshte parashikuar se:
Detyrimet kryesore te shitesit jane:
1. t'i dorezoje sendin bleresit;
2. kur fitimi i pronesise mbi sendin, ose i te drejtave reale mbi te, nuk eshte pasoje e menjehershme e kontrates, duhet te dorezoje te gjitha dokumentet perkatese per fitimin e pronesise se tyre, sipas kushteve te parashikuara nga kontrata apo nga ligji;
3. te garantoje bleresin nga zhveshja, nga veset dhe nga mosperputhja e cilesive te sendit me kontraten.
Neni 49 i ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", parashikon se ;
Fatura tatimore
Cdo shitblerje mallrash apo te drejtash, si dhe cdo kryerje punimi apo sherbimi, qe eshte pjese e veprimtarise tregtare, eshte objekt faturimi.
Neni 50
Fatura tatimore me TVSH
Tatimpaguesi, qe i nenshtrohet tatimit mbi vleren e shtuar (TVSH), sa here qe ofron mallra apo sherbime per nje person tjeter, duhet te leshoje fature tatimore me TVSH, ne perputhje me ligjin nr. 92/2014, "Per tatimin mbi vleren e shtuar", te ndryshuar".
Neni 51
Leshimi i fatures tatimore
1. Shitesi leshon fature tatimore dhe bleresi duhet ta kerkoje ate ne kohen e realizimit te shitjes apo te kryerjes se punimit ose sherbimit. Fatura tatimore pergatitet nga shitesi ne jo me pak se dy kopje, nga te cilat njeren e merr dhe e ruan bleresi, kurse tjetren e mban dhe e ruan shitesi. Faturat pergatiten me numer rendor progresiv
Nga sa me lart konkludohet lehtesisht se: Fatura tatimore e paraqitur nr 19 date 10.07.2020 verteton plotesisht se, leshimi i kesaj fature eshte shprehje e vullnetit dypalesh te shitesit e bleresit per kryerjen e transaksionit te shitjes se sendit batipal. Nenshkrimi e vulosja nga perfaqesuesit e te dy paleve shites e bleres konfirmon kalimin e pronesise nga shitesi tek bleresi BE-IS shpk. Referuar e ne zbatim te percaktimeve te nenit 49 te ligjit 9920/2008, fatura tatimore e paraqitur pervec te tjerave, permban emrin dhe adresen e paleve, daten e realizimit te shitjes ose sherbimit, emertimin e sakte te tyre, cmimin e plote te shitjes, daten dhe vendin e leshimit, si dhe emrin NIPT e adresen e paleve. Nga permbajtja e ketyre elementeve ne faturen tatimore, te paraqitura ne SPE, ne provojme para AK, faktin krijues te se drejtes sone mbi pronesine e sendit Mjet (Batipal) per vendosje parmakesh metalik (guardrails). Lidhur me sa me siper, ne theksojme se detyrimi yne lidhet vetem ne provimin e fakteve per te cilat kemi barren e proves (te disponimit te mjetit batipal) ndersa persa i perket dyshimit te KVOse se nuk e dipsonojme kete mjet ky perben nje fakt shues, per te cilin ne si ofertues nuk kemi detyrim qe te paraqesim ndonje prove. Detyrimi per te provuar kete fakt shues i perket KVO-se, e cila normalisht e gjate arsyetimit te skualifikimit do duhej te paraqiste argumenta e prova perse nuk eshte bindur se nuk e diponojme kete mjet. Persa kohe qe nje fakt i tille KVO nuk arrin ta provoje, atehere nuk qendron arsyeja e skualifikimit. Nga ana tjeter, KVO nqs nuk ka qene e bindur apo kishte dyshime per vertetesine e deklarimeve per disponimin e ketij mjeti, mund te shfrytezonte te drejten qe i jep ligji per te kerkuar shpjegime apo

dokumentacion tjeter shtese por edhe te shfrytezonte parashikimin e DT per verifikimin ne vendin ku BE IS shpk ka deklaruar se ndodhet ky mjet. Po keshtu ka patur edhe autorizimin nga BE-IS qe ne cdo kohe mund te bente kete verifikim me ose pa paralajmerim. Gjithashtu , neni 62 i LPP i jep mundesine AK qe edhe gjate fazes se zbatimit te kontrates ne cdo kohe te kontrollonte deklarimin mbi disponueshmerine e ketij mjeti. Persa me siper, kjo arsye skualifikimi nuk qendron.'

III.1.9. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht se për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, sic është rasti i mjetit "Batipal", kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates / kontratave.
Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k KPP vëren se shoqëria "Be-Is" sh.p.k. ka paraqitur Deklaratë Mbi Disponimin e Makinerive ku, ndër të tjera, është deklaruar në pronësi mjeti Batipal me faturë tatimore shitje nr.19, datë 10.07.2020. Gjithashtu është paraqitur faturë tatimore shitje n.19, datë 10.07.2020, me shitës A.I dhe blerës shoqërinë "Be-Is" sh.p.k si dhe foto të mjetit. Pra rezulton se nuk është paraqitur kontrata e blerjes apo çdoganimit sic është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik "Be-Is" sh.p.k, anëtar i BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k, nuk plotëson kriterin e kualifikimit pasi nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor për mjetin "Batipal".
Kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se

"*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni".*

Gjithashtu, kuadri ligjor, parashikon një sërë elementësh, si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese.

Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedurial të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se:

"[…] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit […]".

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k përsa i përket arsyeve të tjera të skualifikimti të tij, nga procedura e mësipërme e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE "Be-Is" sh.p.k & "Griald" sh.p.k për procedurën e prokurimit me me Nr.REF-65462-07-14-2020, me objekt: Loti XII: "*Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga k/Patos - Ballsh + rruga Ballsh – Fratar + rruga Ballsh - Aranitas + rruga kr/rruga nacionale – Bylis + rruga Metohasim - Kafaraj (61,4 km)"*, me fond limit 171.744.991 (njeqind e shtatedhjete e nje milion e shtateqind e dyzete e kater mije e nenteqind e nentedhjete e nje) lekë pa tvsh, faza e parë parakualifikuese zhvilluar me date 05.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1134 Protokolli
Datë 18.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	**Anëtar**	**Anëtar**	**Anëtar**
Enkeleda Bega	**Vilma Zhupaj**	**Lindita Skeja**	**Merita Zeqaj**

Kryetar
Jonaid Myzyri

Jonaid Myzyri
Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2020.10.23 05:28:48 +02'00'